

PËRGJEGJËSIA E FËMIJËVE NDAJ SHOQËRISË

Të drejtat, përgjithësisht, shkojnë bashkë me përgjegjësitë. Ato nuk mund të ndahen.

Edhe të drejtat e fëmijëve parakuptojnë përgjegjësinë e tyre ndaj vetvetes dhe ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë.

P. sh. e drejta e fëmijëve për shkollim parakupton përgjegjësinë e fëmijëve për:

1. vijimin e rregullt të mësimi,
2. respektimin e mësimeve dhe të personelit tjetër të shkollës,
3. respektimin e shokëve të klasës,
4. respektimin e rregullave të shkollës,
5. kryerjen e detyrave të shtëpisë,
6. përvetësimi e programit shkollor.

E drejta për informim parakupton përgjegjësinë për:

1. lexim,
2. kërkim të informacionit,
3. verifikim të informacionit nga burime të ndryshme,
4. komunikim,
5. dëgjim të vëmendshëm, etj.

Edukimi i fëmijëve për të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre, sikurse edhe zhvillimi i tyre, fillimisht bëhet përmes lojës.

Edukimi i fëmijëve për të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre, prandaj, duhet të fillojë në moshën e hershme të fëmijëve. Fillimisht në familje dhe, pastaj, në institucionet parashkollore.

Shkolla është institucioni, në të cilën fëmijët, në mënyrë të organizuar, do të duhej të aftësoheshin për t'i njohur dhe kuptuar të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre.

Edukimi për të drejtat dhe përgjegjësitë e fëmijëve s'ka të bëjë vetëm me fëmijët, por me të gjithë qytetarët, sepse nga vetë qytetarët varet kualiteti i jetës dhe demokratizimi i shoqërisë, pra jo vetëm nga politikanët, siç mendohet shpesh dhe gabimisht.

Të gjithë qytetarët duhet të mësohen ta përdorin ligjin për mbrojtjen e të drejtave të tyre.

Të drejtat e fëmijëve, por edhe të drejtat e tjera, në përgjithësi, mund të kuptohen më së miri në moshën e re. Programet shkollore, prandaj, kanë rol të rëndësishëm në përvetësimin e të gjitha vlerave, si: demokracisë, të drejtave të njeriut, etj.

Përgjegjësia parakupton:

- **respektimin e vetvetes dhe të tjerëve;**
- **shprehjen e pikëpamjeve dhe të ndjenjave personale hapur dhe dëgjimin me vëmendje të të tjerëve;**
- **mbrojtjen e të drejtave personale dhe të drejtave të të tjerëve nga çdo cënim, sulm, agresion.**
- **mbështetjen e situatave të reja progresive;**
- **simpatitë ndaj pikëpamjeve dhe ndjenjave të të tjerëve;**
- **aftësinë për të punuar dhe bashkëpunuar me të tjerët, për të qenë anëtar i një grupi;**
- **aftësinë për kuptuar shumëllojshmërinë e mënyrave për zgjidhjen e konflikteve dhe problemeve.**

Shoqëritë moderne dhe të qytetëruara përballen me sfida të mëdha për krijimin e komuniteteve me prejardhje të ndryshme etnike, fetare dhe shoqërore.

Shkollës i takon përgatitja e nxënësve për të jetuar dhe bashkëpunuar në paqe, në komunitetin e tyre dhe me komunitetet e tjera.

Shkolla duhet të zhvillojë aftësitë njohëse të nxënësve:

- **formimin e opinioneve personale;**

- mësimin nga përvoja dhe reflektimi i tyre;
- përdorimin e argumenteve në mënyrë logjike;
- shprehjen e mendimeve qartë dhe bindshëm.

Përveç aftësive njohëse, shkolla duhet t'i aftësojë nxënësit

- për të mbajtur qëndrim ndaj zhvillimeve në shoqëri,
- për t'i interpretuar zhvillimet, dhe
- për të marrë vendime në pajtim me të mirën e shoqërisë.

Nxënësit duhet të zhvillojnë:

- aftësinë për mirëkuptim me të tjerët: kuptimi i përvojave të të tjerëve, bashkëpunimi dhe krijimi i qëllimeve të përbashkëta me të tjerët;
- ndjenjen e efikasitetit: efekti i pjesëmarrjes në komunitet, sepse pjesëmarrja dhe veprimi në komunitet ka vlerë për shoqërinë.

Lënda e Edukimit qytetar ofron njohuri për përgatitjen e fëmijëve për qytetërim. Ajo përfshin kurse të veçanta dhe kombinohet me studimet dhe shkencat shoqërore.

Për t'u bërë qytetarë të vlefshëm nuk mjaftojnë vetëm njohuritë, por kërkohet:

- kultivimi i qëndrimeve pro-shoqërore,
- aftësimi për pjesëmarrje në grupe shoqërore,
- inkurajimi i prirjeve për të vepruar sipas besimeve personale të secilit individ.

Këto vlera arrihen gjatë gjithë shkollimit dhe gjatë gjithë jetës. Pra, nuk mund të arrihen vetëm me mësimin e një teme ose vetëm të një lënde.

Ndjenjen e përgjegjësisë së fëmijëve ndaj shoqërisë e zhvillojnë:

1. Ndjenja e mirëkuptimit, që formohet:
 - me pjesëmarrjen e fëmijëve në grup,
 - me bashkëpunimin e tyre në nxënien e mësimëve, dhe

- me mbështetjen e tyre në njëri-tjetrin, në kryerjen e detyrave shkollore;

2. Ndjenja e efikasitetit zhvillohet në klasa të menaxhuara në mënyrë demokratike, ku nxënësit diskutojnë lirshëm.

Shkolla duhet t'u ofrojë fëmijëve lirinë, në mënyrë që ata ta kuptojnë vlerën e saj, t'u ofrojë mundësinë për marrjen e iniciativës dhe të bëhen të pavarur.

Ndjenja e efikasitetit formohet kur fëmijëve u mundësohet pjesëmarrja në krijimin e mjedisit në shkollë.

PZTETJE:

1. Të drejtat shkojnë bashkë me përgjegjësitë:

- a) po,
- b) jo.

2. E drejta e fëmijëve për shkollim parakupton:

- a)
- b)
- c),
- ç)etj.

3. Edukimi i fëmijëve për të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre, duhet të fillojë:

- a) në moshën e hershme, në familje, përmes lojërave,
- b) në moshën më të vonë, në shkollën fillore.

4. Mbrojtja më e mirë e të drejtave të fëmijëve është:

- a) mbrojtja ligjore,
- b) mbrojtja tradicionale.

5. Përgjegjësia parakupton:

- a) respektimin e vetvetes,
- b) respektimin e të tjerëve,
- c) respektimin e vetvetes dhe të tjerëve.

6. Lënda mësimore që ofron njohuritë për përgatitjen e fëmijëve për qytetërim, quhet

.....

7. Përvetësimi i vlerave bëhet:

- a) vetëm gjatë shkollimit,
- b) edhe gjatë gjithë jetës.

8. Aftësimi i organizuar i fëmijëve për të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre bëhet:

- a) gjatë shkollimit,
- b) gjatë gjithë jetës.